



Dauh'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1823 prot

Vlorë, më 21.05.2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë. _____ .2024

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT DHE HARTAVE STRATEGJIKE
PËR REDUKTIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË E VLORËS**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 19.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2 , neni 9.1, pika 1.adhe 1.b , neni 23, pika 14 , në Ligjin nr.93/2015 “ Për turizmin”, në Ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, ne Udhëzimin nr.2 datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike shoqërore” neni 8 si edhe në propozimet e subjekteve te ndryshme që operojnë në fushën e hotelerisë , Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____ ,

VENDOSI:

1.Miratimin e Plan-Veprimit dhe Hartave Strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë e Vlorës.

2. Per zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1323 prot.

Vlorë, më 21.052024

RELACION

MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT DHE HARTAVE STRATEGJIKE PËR REDUKTIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË E VLORËS”

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi që po ju paraqesim për miratim lind si domosdoshmëri e përmbushjes të detyrimeve ligjore të qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të popullatës. Në këto kushte, Bashkia Vlorë ka inicuar hartimin e Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat (PLVZH) në territorin e saj.

Zonat bregdetare janë zonat më të ekspozuara ndaj zhurmave kryesisht përgjatë sezonit turistik. Ndër zonat bregdetare më të preferuara përgjate sezonit turistik janë ato përgjatë Bashkisë Vlorë. Disa nga problematikat kryesore që lidhen me ndotjen akustike në bashki janë: **mungesa e planeve vendore të veprimit mbi zhurmën, mungesa e monitorimit të vazhdueshëm të niveleve të zhurmave dhe e kontroleve të ushtruara mbi veprimtaritë që gjenerojnë zhurma si dhe mungesa e transparencës nga institucionet përgjegjëse mbi nivelet e zhurmave.**

Duke marrë në konsideratë gjendjen dhe problematikën e ndotjes nga zhurmat, komunitetet përgjatë këtyre zonave janë të pa informuar mbi rolin që ka pushteti vendor në administrimin dhe reduktimin e zhurmave.

Plani i veprimit për zhurmat ka për qëllim të identifikojë, evitojë, parandalojë dhe zbusë efektet e dëmshme që vijnë për shkak të ekspozimit ndaj zhurmave përgjatë zonës bregdetare në qytetin e Vlorës. Nëpërmjet planit paraprak të veprimit synohet të realizohet një analize e situatë aktuale në lidhje me nivelet dhe burimet kryesore të zhurmave në 57 stacione monitorimi në bashkinë e Vlorës dhe 9 stacione monitorimi në Orikum.

Gjithashtu ky plan veprimi analizon dhe parashikon masa ligjore, administrative dhe organizative të domosdoshme për t'u ndërmarrë në përmbushje të kërkesave të ligjit për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis, me synimin e administrimit të qëndrueshëm dhe reduktimit të nivelit të zhurmave në mjedis.

Në këtë kontekst, objektivi kryesor i Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Objektivat e PLVZHBV

Ndër objektivat kryesore të Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat përfshihen:

- Fuqizimi institucional i Bashkisë Vlorë për menaxhimin e zhurmave.
- Përmirësimi i infrastrukturës për reduktimin e zhurmave.
- Forcimi i ligjit dhe masave për kontrollin e zhurmës.
- Monitorimi i niveleve të zhurmave në 57 stacione monitorimi në Bashkinë e Vlorës dhe 9 stacione monitorimi në Orikum.
- Ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i operatorëve që gjenerojnë zhurma për pasojat e saj në mjedis dhe shëndet dhe masat që duhet të zbatohen për kontrollin dhe menaxhimin e saj.

Bashkëlidhur këtij projekt vendimi është plani i veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave i cili është përgatitur në mënyrë të detajuar nga një grup specialistësh i Bashkisë së Vlorës dhe paraqet në mënyrë të detajuar strategjinë për reduktimin e zhurmave.

KRYETAR

Ermal Dredha





BASHKIA VLORE



MIRATOI

KRYETAR

Ermal Dredha

**PLANI PARAPRAK I VEPRIMIT PËR
REDUKTIMIN E ZHURMAVE NË
BASHKINË VLORE**

2024

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE	4
1.1.	Objektivi dhe qëllimi i Planit paraprak të veprimit	4
2.	PROFILI I BASHKISË VLORË	5
2.1.	Pozita gjeografike.....	5
2.2.	Të dhëna demografike.....	6
2.3.	Zhvillimi ekonomik.....	7
3.	KUADRI LIGJOR DHE POLITIK PËR MONITORIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS	7
3.1.	Kuadri ligjor dhe politik për monitorimin e zhurmës në mjedis në BE	7
3.2.	Kuadri ligjor dhe politik për monitorimin e zhurmës në mjedis në Shqipëri	10
	Tabela 2: Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të brendshme dhe të jashtme	12
3.3.	Plani kombëtar i veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis (PKVMZM)	12
3.3.1	Qëllimi i Planit Kombëtar të Veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis	13
3.3.1	Objektiva kryesore të Planit Kombëtar të Veprimit	13
3.4.	Strukturat kryesore përgjegjëse për administrimin e zhurmës në mjedis.....	13
3.5.	Roli dhe përgjegjësitë e njëjësive të qeverisjes vendore në menaxhimin e zhurmave	14
4.	METODOLOGJIA MBI IDENTIFIKIMIN DHE MONITORIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË VLORË	14
4.1.	Evidentimi i zonave problematike në bashkinë Vlorë.....	15
4.1.1	Hulumtimi mbi perceptimin e komuniteteve lokale, bizneseve dhe pushtetit vendor mbi nivelin e zhurmave	15
4.1.2	Realizimi i takimeve me grupe nga komunitetet lokale dhe bizneset për të kuptuar problematikat që lidhen me zhurmat	16
4.2.	Metodologjia e monitorimit alternativ të zhurmave në zonat bregdetare.....	16
5.	PERCEPTIMI QYTETAR MBI NIVELIN E ZHURMAVE NE BASHKINË VLORË	18
5.1	Rezultatet nga pyetësorët e zhvilluar me qytetarët në Bashkinë Vlorë	18
5.2	Rezultatet nga workshopet e zhvilluara me grupet e interesit	19
6.	VLERËSIMI I NIVELIT TË ZHURMAVE DHE HARTËZIMI I TYRE NË BASHKINË VLORË.....	21
6.1.	Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Gusht 2023 (Zona bregdetare Vlorë).....	21
6.2.	Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Shtator 2023 (Zona bregdetare Vlorë).....	23
6.3.	Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Gusht 2023 (Zona Plazhi i vjeter).....	25
6.4.	Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Shtator 2023 (Zona Plazhi i vjeter).....	27

7. KONKLUZIONE.....	29
8. MASAT E PROPOZUARA PËR REDUKTIMIN E ZHURMAVE NË MJEDIS.....	31
9. ANEKS I. HARTAT E ZHURMAVE PËR BASHKINË VLORË (ZONA BREGDETARE).....	33
10. ANEKS II. STACIONET E MONITORIMIT PËR BASHKINË VLORË (ZONA BREGDETARE) 37	
11. ANEKS III. PAJISJA E PËRDORUR PËR MONITORIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË VLORË	38

Lista e Figurave

Figura 1: Bashkia Vlorë.....	6
Figura 2: Skema e metodologjisë së zbatuar për identifikimin dhe monitorimin e zhurmave.....	15
Figura 3: Fotografi gjatë plotësimin të pyetësorëve në Bashkinë Vlorë.....	16
Figura 4: Fotografi gjatë takimeve.....	16
Figura 5: Skema e monitorimit alternativ të zhurmave në zonat bregdetare	18
Figura 6: Harta e Bashkisë Vlorë.....	20
Figura 7: Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Gusht 2023), Vlorë.....	22
Figura 8: Niveli i zhurmave gjatë fundjavës paradite dhe darkë (Gusht 2023) Vlorë	22
Figura 9: Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Shtator 2023), Vlorë.....	23
Figura 10: Niveli i zhurmave gjatë fundjavës paradite dhe darkë (Shtator 2023), Vlorë	24
Figura 11: Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Gusht 2023), Plazhi i vjeter.....	25
Figura 12: Niveli i zhurmave gjatë fundjavës paradite dhe darkë (Gusht 2023), Plazhi i vjeter	26
Figura 13: Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Shtator 2023), Plazhi i vjeter	27
Figura 14: Niveli i zhurmave gjatë fundjavës paradite dhe darkë (Shtator 2023)	28

Lista e Tabelave

Tabela 1: Akte normative në lidhje me zhurmat në mjedise urbane	11
Tabela 2: Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të brendshme dhe të jashtme	12
Tabela 3: Metodologjia e monitorimit të zhurmave në Bashkinë Vlorë	17

1. HYRJJE

Shqipëria ka realizuar monitorimin e zhurmave në disa qytete dhe bashki në linjë me programin kombëtar të monitorimit dhe sipas standarteve të organizatës botërore të shëndetësisë.¹

Rregullat kryesore për administrimin e zhurmave në mjedis përcaktohen në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”², i ndryshuar me ligjin Nr.39/2013, të cilat rregullojnë nivelet e lejuara të zhurmave. Sipas këtij ligji, **organet e qeverisjes vendore** janë autoritetet të cilat duhet të hartojnë dhe zbatojnë planet vendore të veprimit për zhurmën.

Zonat bregdetare janë zonat më të ekspozuara ndaj zhurmave kryesisht përgjatë sezonit turistik. Ndër zonat bregdetare më të preferuara përgjate sezonit turistik janë ato përgjatë Bashkisë Vlorë. Disa nga problematikat kryesore që lidhen me ndotjen akustike në bashki janë: **mungesa e planeve vendore të veprimit mbi zhurmën, mungesa e monitorimit të vazhdueshëm të niveleve të zhurmave dhe e kontroleve të ushtruara** mbi veprimtaritë që gjenerojnë zhurma si dhe mungesa e transparencës nga institucionet përgjegjëse mbi nivelet e zhurmave. Nga Raporti më i fundit i gjendjes së Mjedisit³ është vëne re se nga 43 stacione për matjen e nivelit të zhurmave në të gjithë Shqipërinë për zonën e projektit janë vetëm 4 stacione në qytetin e Vlorës si Uji i ftohtë, Përballë Hotel Bolonjes, Xhamia dhe Hyrja e qytetit. Po ashtu nga ky raport vërehet tejkalim të normës ditën në të gjitha stacionet. Niveli më i lartë është në stacionin “Uji i Ftohtë” ku vlera e monitoruar është 13.7% më e lartë se norma (55dB), ndërsa niveli më i ulët ditën është monitoruar në stacionin “Hyrja e Qytetit” ku kemi tejkalim të normës me 1.7%. Si pasojë nivelet e zhurmave në këtë bashki tejkalojnë nivelet e përcaktuara nga legjislati shqiptar si dhe standartin e BE.

Duke marrë në konsideratë gjendjen dhe problematikën e ndotjes nga zhurmat, komunitetet përgjatë këtyre zonave janë të pa informuar mbi rolin që ka pushteti vendor në administrimin dhe reduktimin e zhurmave.

Plani i veprimit të zhurmave në mjedis është një dokument ligjor, i cili është ndërtuar në mbështetje të përcaktimeve të ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”, i ndryshuar me ligjin Nr.39/2013; Udhëzimit Nr.1037/1, datë 12.4.2011”për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës mjedisore dhe së fundmi Udhëzimin Nr.1, datë 19/02/2018, “Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”. Mungesa e një plani konkret veprimi/hartëzimi/masa të nivelit të zhurmave nga bashkia ka sjellë një hendek të burimit të informacionit për komunitetet dhe organizatat lokale.

1.1.Objektivi dhe qëllimi i Planit paraprak të veprimit

Plani i veprimit për zhurmat ka për qëllim të identifikojë, evitojë, parandalojë dhe zbusë efektet e dëmshme që vijnë për shkak të ekspozimit ndaj zhurmave përgjatë zonës bregdetare në qytetin e

¹ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en

² <http://ëëë.ishp.gov.al/ëp-content/uploads/2015/04/Ligji-9774-dt.12.07.07-p%C3%ABr-zhurmat.pdf>

³ [rgjim_2020.pdf \(akm.gov.al\)](#)

Vlorës. Nëpërmjet planit paraprak të veprimit synohet të realizohet një analizë e situatë aktuale në lidhje me nivelet dhe burimet kryesore të zhurmave në 57 stacione monitorimi në Bashkinë e Vlorës dhe 9 stacione monitorimi në Orikum.

Objektivat kryesore të këtij plani janë:

- Zhvillimi dhe aplikimi i një metodologjie alternative që bazohet në angazhimin qytetar dhe monitorimin e zhurmave.
- Vlerësimi i perceptimit qytetar mbi zonat më të ekspozuara ndaj zhurmave.
- Monitorimi i niveleve të zhurmave në 57 stacione monitorimi në Bashkinë e Vlorës dhe 9 stacione monitorimi në Plazh të vjetër.
- Konkluzione dhe rekomandime për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave.

Ky plan paraprak veprimi do të shërbejë për të gjithë aktorët lokalë të Bashkisë Vlorë në integrimin e kërkesave specifike të këtij plani në të gjitha çështjet e zhvillimeve vendore të cilat kanë një ndikim direkt me komunitetin. Vlen për tu theksuar që ky plan paraprak veprimi do shërbejë si një material thelbësor për inicimin e zhvillimit të planit final të zhurmave në Bashkinë Vlorë i cili është në përgatitje.

2. PROFILI I BASHKISË VLORË

2.1.Pozita gjeografike

Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 Njësi Administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Bashkia Vlorë kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Vlorës.

Kjo zonë ka në përbërje dhe parkun detar-bregdetar Sazan-Karaburun, që është i vetmi i këtij lloji në vendin tonë. Zona ka praninë e minorancave etnike, përkatësisht minorancës Greke në zonën e Nartës dhe asaj rome e egjiptiane në Novoselë e Shushicë.

Bashkia e Vlorës ka një sipërfaqe prej 616.85 km² me densitet 169.9 banorë/km² ndërsa sipas të dhënave të regjistrimit civil, densiteti është 314.73 banorë/km².




Figura 1: Bashkia Vlorë

2.2. Të dhëna demografike

Sipas Census-it të vitit 2011 Bashkia ka 104,827 banorë, ndërsa në janar 2023 rezultojnë 202,751 banorë (gra 101,332, burra 101,419). Nga këto të dhëna kemi një shpërndarje pothuajse të barabartë burra-gra të popullsisë residente.

Modeli më i zakonshëm familjar në Vlorë është një familje e përbërë nga katër anëtarë. Jetëgjatësia mesatare është 71.4 vjeç, 68.5 për burrat dhe 74.3 për gratë. Sipas të dhënave nga regjistrimet lokale, moshë mesatare në rajon është 28.6 vjeç. Në zonat urbane, kryesisht në qytetin e Vlorës janë të regjistruar rreth 71% e popullsisë, ndërsa popullsia në zonat rurale dhe gjysmë urbane (Orikum), përfshin rreth 29% e popullsisë.

Shpërndarja e popullsisë së përhershme i referohet në pjesën më të madhe zonave ekzistuese urbane. Qyteti i Vlorës zë vetëm 45% të sipërfaqes totale të tokës urbane pavarësisht nga fakti se, në të përqëndrohet 71% e popullsisë. Sipas INSTAT Censusi i 2011 në bashkinë Vlorë ka patur rreth 14,726 banesa stok ndërkohë aktualisht ka 16,269 ndërtime stok në dispozicion për të absorbuar rritjen e popullsisë. Popullsia e shtëpive të dyta është e përqëndruar në qytetet Vlorë dhe Orikum dhe pjesërisht në Njësinë Administrative Qendër. Popullsia e shtëpive të dyta është e përqëndruar në qytetet Vlorë dhe Orikum dhe pjesërisht në Njësinë Administrative Qendër. Është

vlerësuar se, popullsia aktuale e qytetit dhe zona periurbane në sezonin e verës, duke përfshirë edhe emigrantët e kthyer, ka një rritje të dyfishtë.

Ky trend ka shënuar një ndryshim të shpërndarjes territoriale të popullsisë, nga ajo malore në zonat bregdetare dhe nga perëndimi në jug. Gjatë një pjese të vitit, kryesisht në dimër Vlora ka një përgjysmim të numrit të banorëve rezident për arsye të emigracionit dhe migrimit të brendshëm, por gjatë sezonit të verës ka mjaft qytetarë të kthyer, turista apo vizitorë të përditshëm e sezonal që e ndryshojnë përbërjen e popullsisë. Aktualisht në qarkun e Vlorës banon vetëm 49% e popullsisë së regjistruar.

2.3. Zhvillimi ekonomik

Pozicionimi gjeografik i territorit të Bashkisë Vlorë veçanërisht me zgjerimin e saj që nga grykëderdhja e Vjosës e deri në malësinë e Llogorasë, kanë shtuar mjaft larmishmërinë dhe potencialin turistik të saj. Lagia nga dy dete Joni dhe Adriatiku, ekzistenca e shumë monumenteve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, e identifikon këtë territor si zonë me potenciale të spikatura të zhvillimit të turizmit balnear, agro-turizmit, aktiviteteve të peshkimit turistik, etj.

Zhvillimi i turizmit është ndër burimet më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, ku turizmi bregdetar kombinohet mjaft mirë me turizmin kulturor. Nga ana tjetër ky sektor në nivel kombëtar bën pjesë në grup aktivitetin e tretë së bashku me tregtin dhe transportin (me 20%) ku gratë janë të punësuara, ndërsa për burrat është sektori i dytë (me 28.8%). Gjithsesi në ekonomitë e vogla familjare gratë janë të vetëpunësuara në agroturizëm.

Burimet kryesore ekonomike janë turizmi, bujqësia, blegtoaria dhe industria. Si një qytet bregdetar, Vlora është edhe një qendër e rëndësishme e peshkimit. Karakteri turistik i zonës ka çuar në zhvillimin e madh të shtëpive të para e të dyta, si dhe të shërbimet e turizmit përgjatë zonës bregdetare. Kjo pasqyrohet në luhatjet e larta sezonale të popullsisë të lidhura me ekonominë e turizmit. Potencialet e zhvillimit industrial në qytetin e Vlorës lidhen padyshim me pozicionin gjeografik, portin, burimet natyrore si naftë, gaz natyror, bitum dhe kripë. Burimet natyrore krijojnë mundësi për të zhvilluar degë të tilla si industri nxjerrëse dhe përpunuese, peshkim, manifakturë, tekstile, ndërtim si dhe potencial të lartë për zhvillim të energjisë së rinovueshme.

3. KUADRI LIGJOR DHE POLITIK PËR MONITORIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS

3.1. Kuadri ligjor dhe politik për monitorimin e zhurmës në mjedis në BE

Direktivat evropiane rregullojnë nivelet e lejuara të zhurmave nga burimet e ndotjes si dhe përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektorë të tjerë.

Plani i veprimit sipas direktivave të Bashkimit Evropian ka si kërkesë përgatitjen e hartave të zhurmës. Pas përgatitjes së planit kombëtar, direktiva parashikon dhe përcakton afate të hartimit të planeve lokale të zhurmave. Hartat e zhurmave përmbajnë më shumë elemente për një zonë të caktuar. Ato japin ngjyra të caktuara dhe të diferencuara zonat ku lejohet apo ndalohet një nivel i caktuar i zhurme.

Një nga objektivat kryesorë të planit është mbrojtja e shëndetit të qytetarëve nga presionet mjedisore. Në mënyrë që të arrihet objektivi kryesor i planit do të jetë e nevojshme:

- të zbatohet një politikë e përmirësuar e zhurmës, e cila të jetë e harmonizuar me njohuritë e fundit shkencore,
- të merren masa për zvogëlimin e zhurmës në burim,
- të përmirësohet planifikimi i qytetit.

Direktiva 2002/49/EC në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore (Direktiva për Zhurmën e Mjedisit - END⁴) është instrumenti kryesor i BE-së për të identifikuar nivelet e ndotjes së zhurmës dhe për të nxitur veprimet e nevojshme, si në shtetet anëtare dhe në nivel të BE-së.

Direktiva e Zhurmës në Mjedis ka si objektiva kryesorë:

- përcaktimin e ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore nëpërmjet hartëzimit të gjeneruesve të zhurmave me metoda të përbashkëta të vlerësimit të nivelit të zhurmave të shteteve anëtare,
- informimin e publikut në lidhje me nivelin e zhurmave dhe efektet e tij,
- miratimin e planeve të veprimit nga shtetet anëtare të BE-së, bazuar në rezultatet e identifikimit të zonave me nivele të larta të zhurmës, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës mjedisore ku është e nevojshme dhe veçanërisht ku nivelet e ekspozimit mund të nxisin efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut.

Direktiva zbatohet ndaj zhurmës me të cilën njerëzit ekspozohen, veçanërisht në zonat e ndërtuara, në parqe publike, në zona të qeta në vende të hapura, në afërsi të shkollave, spitaleve dhe ndërtesave dhe zonave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave. Nuk zbatohet për zhurmën e shkaktuar nga vetë personi i ekspozuar, zhurma nga aktivitetet e brendshme, zhurma e krijuar nga fqinjët, zhurma në vendet e punës, ose zhurma brenda mjeteve të transportit ose për shkak të aktiviteteve ushtarake në zonat ushtarake.

Direktiva kërkon që shtetet anëtare të përgatisin dhe publikojnë, *çdo 5 vjet, hartat e zhurmës dhe planet e veprimit për menaxhimin e zhurmave* për:

- zonat me më shumë se 100,000 banorë
- rrugët kryesore (më shumë se 3 milion automjete në vit)
- hekurudhat kryesore (më shumë se 30,000 trena në vit)
- aeroporte kryesore (më shumë se 50,000 fluturime në vit, duke përfshirë avionë të vegjël dhe helikopterë)

Kur zhvillohen planet e veprimit për menaxhimin e zhurmave, autoritetet e shteteve anëtare duhet të konsultohen me publikun përkatës.

⁴ Environmental Noise Directive

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se Direktiva nuk përcakton vlerat kufizuese ose të synuara dhe as nuk përcakton masat që duhet të përfshihen në planet e veprimit, duke i lënë këto çështje në zgjedhjen e autoriteteve kompetente të shteteve anëtare.

Zhurma mjedisore në nivel të BE-së rregullohet nëpërmjet matjeve në burim të zhurmës, me legjislacionin mbi çështje të tilla si kufijtë e harmonizuar të zhurmës për automjetet, pajisjet e jashtme dhe produktet e tjera të gjenerimit të zhurmave.

Sa i takon fushave të gjenerimit të zhurmave në burim, Bashkimi Evropian ka një kuadër ligjor të mirëpërcaktuar për zhurmat që gjenerohen nga trafiku rrugor, aviacioni, hekurudhat dhe nga pajisjet për përdorim të jashtëm.

Sektorët kryesorë që gjenerojnë zhurma në mjedis, të cilët janë trajtuar njëkohësisht dhe nga direktivat e BE, janë si më poshtë:

1. Transporti (rrugor, ajror, hekurudhor)
2. Aktivitetet e shërbimit social (klubet e nates dhe diskot, bare, restorante);
3. Pajisje dhe makinerite (perpunim metali, prerje metalesh, sharrat, gjeneratore, elektromotorre, kompresore, çekice pneumatike etj.)

Për rastin tonë, për zonat të cilat janë marrë në shqyrtim kemi vetëm dy burimet e para, sepse qyteti është bregdetar dhe është marrë në konsideratë një periudhë të vitit që është sezoni turistik. Ndotja nga zhurmat gjenerohet nga:

1. Transporti (rrugor)
2. Aktivitete të shërbimit social (klubet e natës dhe diskot, bare, restorante);

Kërkesat e Direktivave Europiane për zhurmat e gjeneruara nga transporti rrugor

Kërkesat specifike lidhur me transportin rrugor dhe nivelet e lejuara të zhurmave nga ky transport përcaktohen në direktivën bazë të Bashkimit Evropian për administrimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis (Direktiva 2002/49/EC).

Direktiva europiane për zhurmat dhe veçanërisht për zhurmat e gjeneruara nga sektori i transportit rrugor kërkojnë që plani i veprimit për administrimin mjedisor të zhurmave nga ky sektor të përmbushë një sërë objektivash sic janë:

- Identifikimin e zonave me efekte më të theksuara të zhurmave dhe popullsia e ekspozuar nga këto pika;
- Identifikimin e pikave ku janë ndërtesat e ndjeshme (spitale, shkolla, çerdhe, kopeshte etj.);
- Përcaktimin dhe vlerësimin e masave për reduktimin e zhurmave që shkaktojnë shqetësime ndaj popullsisë;
- Përcaktimi i kostove të nevojshme për këto ndërhyrje.

Kërkesat e direktivave të Bashkimit Europian për zhurmat në klubet e natës dhe diskot, bare, restorante

Kërkesat e përgjithshme percaktohen në direktiven bazë të Bashkimit Europian (DIREKTIVA 2002/49/EC) ndërsa kërkesa specifike ka në direktivat e vecanta (DIREKTIVA 2003/10/EC) që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerezve të ekspozuar ndaj tyre përfshi këtu dhe personelin që shërben në këto restorante dhe disko.

Në këto dokumente kërkohet që nivelet e zhurmave që gjenerohen nga këto aktivitete të jenë në nivelet e lejuara dhe që nuk shkaktojnë dëmtrim të shëndetit të personave të ekspozuar ndaj tyre.

3.2. Kuadri ligjor dhe politik për monitorimin e zhurmës në mjedis në Shqipëri

Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar me **Ligjin nr. 39/2013** është kuadri ligjor kryesor ku mbështetet menaxhimi i zhurmave mjedisore. Fokusi kryesor i tij është bashkëpunimi ndër-institucional dhe ngritja e politikave të integruara në menaxhimin e zhurmës. Zbatimi i ligjit ka si qëllim vlerësimin e nivelit të zhurmës në mjedis (kryesisht në mjediset urbane), përcaktimin e uljes të nivelit të zhurmave nga burimet pikësore apo të lëvizshme, hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e tyre, hartimin e hartave, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe ngritjen e infrastrukturës e zbatimi i standardeve për monitorimin e zhurmës dhe krijimi i bashkëpunimit midis aktorëve për menaxhimin e zhurmës në mjedis.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” në seksionin dedikuar funksioneve të bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, krahas detyrimit për mbrojtjen në tërësi të komponentëve mjedisorë, edukimin dhe promovimin e mbrojtjes së tyre, shprehet konkretisht në Nenin 26/pika 2 se Bashkia ka si funksion të vetin “*Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike*”.

Për krijimin e një kuadri të plotë ligjor në lidhje me zhurmat e krijuara në mjedise urbane janë hartuar një sërë aktesh nënligjore (Vendime të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzime), të paraqitura si më poshtë:

Nr.	Akt nënligjor	Nr. akt	Datë	Emërtimi
1		613	7.9.2011	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave”
2	Vendim i Këshillit të Ministrave	123	17.2.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis
3		587	7.7.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike (<i>Ndryshuar me Akt Normativ nr. 2/2012</i>)

1	Udhëzime	1	19.2.2018	Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat
2		234	25.5.2015	Për miratimin e udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet
3		259	30.7.2012	Për marrjen dhe bashkërendimin e masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik, si dhe për marrjen e masave ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe në zonat turistike e bregdetare
4		1037/1	12.4.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
5		8	27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
6		6527	24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre (i ndryshuar me Udhëzim, nr. 12, datë. 15.06.2010)

Tabela 1: Akte normative në lidhje me zhurmat në mjedise urbane

Bazuar në tabelën e mësipërme, vërehet se aktet nënligjore të hartuara dhe të miratuara janë shumë të hershme në kohë dhe nuk ka pasur ndryshime të tyre gjatë viteteve të fundit. Duke marrë në konsideratë këtë fakt, rekomandohet që të bëhet një përditësim i tyre në përputhje me bazën ligjore të miratuar.

Sa i takon niveleve kufi të gjenerimit të zhurmave, në mjedise të brendshme dhe të jashtme, ato janë të përcaktuara në Udhëzimin nr. 8/2007, për nivelet kufi të zhurmave⁵, si më poshtë:

Nr.	Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA _{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	L _{Amax} Fast (dB)
1	Zona banimi				
1.1	Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
		Bezdi (shqetësim) i mesëm gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
1.2	Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
1.3	Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
1.4	Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
2	Institucione				

⁵ Udhëzim nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

2.1	Klasa mësimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmëri e bisedës, vështirësi në kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjatë mësimit	-
2.2	Dhomat e fjetjes në kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
2.3	Oborri i shkollës, vendet e lojërave në shkollë	Bezdi (shqetësim) - (burime të jashtme)	55	Koha e pushimit	-
2.4	Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit natën Prishja e gjumit ditën dhe në mbrëmje	30 30	8 16	40
2.5	Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim në pushim, çlodhje			
3	Zona me aktivitetet social-ekonomik				
3.1	Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
4	Mjedis urban				
4.1	Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
4.2	Ceremoni, festivale dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët < 5 herë/vit)	100	4	110
4.3	Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
4.4	Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarrët dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit) Dëmtim dëgjimit (fëmijët)	-	-	140 120
5	Parqe publike				
5.1	Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë			

Tabela 2: Nivelet kufi të zhurmës për mjedis të brendshme dhe të jashtme

3.3. Plani kombëtar i veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis (PKVMZM)

Plani kombëtar i veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis i vitit 2010 është dokumenti i cili hap rrugën e zhvillimit të planeve lokale të zhvillimit, përgatitjen e hartave lokale të zhurmës dhe asaj kombëtare. Hartimi i planeve lokale të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis është një kërkesë që buron nga neni 8 të Ligjit 9774, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Plani kombëtar i veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis është miratuar me **VKM Nr. 123, datë 17.02.2011, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”** dhe thekson domosdoshmërinë e zbatimit të standardeve evropiane për monitorimin e zhurmës, vlerave dhe metodologjive për monitorim dhe vlerësim të saj.

3.3.1 Qëllimi i Planit Kombëtar të Veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis

Nëpërmjet këtij plani veprimi synohet të behet nje analize e situates aktuale, te pergjegjesive institucionale dhe te boshlleqeve ekzistuese ligjore dhe organizative si dhe te planifikohen masa te domosdoshme me afate dhe buxhet te percaktuar per tu ndermarre me qellim permbushjen e detyrimeve ne kuader te ligjit per administrimin mjedisor te zhurmave, te kerkesave te direktives baze te Bashkimit Evropian per zhurmat dhe te kerkesave te direktivave specifike qe lidhen me kete çështje.

Ky dokument shërben gjithashtu për ministrite, njësite e qeverisjes vendore, strukturat e planifikimit dhe të vendimarrjes që të marrin në konsideratë dhe të integrojnë në planet e tyre kërkesa specifike të përcaktuara në hartat e zhurmave dhe në planet lokale të veprimit për zhurmat.

3.3.1 Objektiva kryesore të Planit Kombëtar të Veprimit

- Përcaktimi i burimeve që gjenerojnë zhurma te cilat paraqesin shqetesim per mjedisin dhe shendetin e njerezve;
- Vleresimi i shkalles se ndikimit ne secilin burim;
- Vleresimi i kuadrit ligjor rregullator i burimeve qe gjenerojne zhurme;
- Aanaliza e pergjegjesive institucionale dhe kerkesa per permiresime te metejshme;
- Politikat e BE-se per zhurmat dhe implementimi i tyre ne legjislacionin kombetar;
- Perllogaritja e kosos se perafert per implementimin e Planit Kombetar te Veprimit per Zhurmat;
- Konkluzione dhe rekomandime per menaxhimin e qendrueshem te zhurmave ne mjedis;

3.4.Strukturat kryesore përgjegjëse për administrimin e zhurmës në mjedis

Institucionet përgjegjëse dhe veprimtaritë e tyre për menaxhimin dhe parandalimin e ndotjes nga zhurmat në mjedis, janë si vijon:

- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, nëpërmjet përcaktimit të niveleve kufi dhe zbatimit të masave mbrojtëse.
- **Ministrinë e linjës** janë përgjegjëse për masat që duhen marrë në kuadër të legjislacionit të tyre të posaçëm, të cilat synojnë menaxhimin e zhurmës në mjedis.
- **Këshilli Teknik për Zhurmat (KTZH)** pranë ministrit si organizëm ndërinstitutional këshillimor për çështjet e zhurmës.
- **Instituti i Shëndetit Publik** është institucioni bazë i cili shërben si referencë për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e saj.
- **Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashkitë)**

Pavarësisht se kuadri ligjor dhe institucional është i përcaktuar qartë, sa i takon menaxhimin dhe administrimin të zhurmave hasen disa sfida kryesore, të tilla si:

- mungesa e hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimit të zhurmave në mjedis në nivel kombëtar dhe lokal,
- moszbatimi i standardeve të OBSH-së dhe BE-së për vlerat kufi të zhurmës në mjedis, kryesisht zonat urbane,
- mungesa e konsolidimit të Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standardeve evropiane,
- zbatimi i legjislacionit mbi menaxhimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis dhe burimet kryesore të saj,
- forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional mbi menaxhimin e zhurmës në mjedis dhe integrimi i çështjes në politika e plane sektoriale,

3.5. Roli dhe përgjegjësitë e njësive të qeverisjes vendore në menaxhimin e zhurmave

Bashkia duhet të bëjë monitorime të vazhdueshme të zhurmave në terren, duke përcaktuar zonat më të ndjeshme në bashkinë Vlorë gjatë sezonit turistik. Bashkia duhet të bëjë mbledhjen e të dhënave dhe krahasimin me vlerat e lejuara të përcaktuara në legjislacionin Shqiptar dhe direktivat e BE. Gjithashtu duhet të behen raportime të vazhdueshme dhe të hartohen plane menaxhimi për zbutjen e ketyre efekteve në bashkëpunim me bizneset dhe komunitetin.

Organet e qeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre kanë keto përgjegjësi:

- Drejtojnë hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshillat e bashkive.
- Drejtojnë procesin e hartëzimit të zhurmës.
- Shpallin zona të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosin kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.
- Kërkojnë nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës.
- U kërkojnë organeve të kontrollit të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.

4. METODOLOGJIA MBI IDENTIFIKIMIN DHE MONITORIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË VLORE

Metodologjia e ndjekur për realizimin e këtij studimi u bazua fillimisht në matjen e perceptimit qytetar mbi nivelet e zhurmave përgjatë bashkisë Vlorë me një fokus në zonën bregdetare. Më pas u bë formulimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve në formën e një studimi me qëllim zhvillimin e plotë të planit të zhurmave dhe integrimin e gjetjeve në politikat lokale




Figura 2: Skema e metodologjisë së zbatuar për identifikimin dhe monitorimin e zhurmave

4.1. Evidentimi i zonave problematike në bashkinë Vlorë

4.1.1 Hulumtimi mbi perceptimin e komuniteteve lokale, bizneseve dhe pushtetit vendor mbi nivelin e zhurmave

Në total në Bashkinë e Vlorës janë plotësuar dhe analizuar **700 pyetësorë**. Nëpërmjet pyetësorëve u siguruan të dhëna mbi zonat më të ekspozuara ndaj zhurmës gjatë sezonit të verës dhe pjesës tjetër të vitit në Bashkinë Vlorë. Pyetësi konsistonte kryesisht në grumbullimin e informacionit që lidhet me nivelin e shqetësimit të qytetarëve ndaj zhurmave, zonat kryesore të cilat janë më të ekspozuara ndaj zhurmave dhe burimet kryesore të zhurmave. Plotësimi i pyetësorëve në Bashkinë Vlorë u realizua përgjatë muajve Tetor - Dhjetor 2023.

Anketimi kishte në fokus grupin e qytetarëve mbi 15 vjeç. Duke ju referuar këtij fakti, grupi i pyetur ka një shpërndarje të larmishme nga 19 deri në 78 vjeç. Zgjedhja e të anketuarve ka qenë rastësore duke sjellë që rezultatet e pyetësorëve të jenë objektiv dhe të besueshëm. Plotësimi i pyetësorit është realizuar në terren duke u fokusuar në lagjet dhe rrugët kryesore si dhe pranë institucioneve arsimore dhe vendore.



Figura 3: Fotografi gjatë plotësimit të pyetësorëve në Bashkinë Vlorë

4.1.2 Realizimi i takimeve me grupe nga komunitetet lokale dhe bizneset për të kuptuar problematikat që lidhen me zhurmën

Janë realizuar 2 takime me grupet e komuniteteve lokale, përfaqësues të Bashkisë, OJF lokale dhe bizneset. Pjesëmarrës në takime ishin përfaqësues nga OJF, specialist të Bashkisë Vlorë, studentë nga shkolla “Pavarësia” si dhe biznese lokale të zonës. Gjatë takimit pjesëmarrësit u angazhuan në punë me grupe ku nëpërmjet hartave të printuara, ata përcaktuan zonat dhe lagjet të cilat kanë problematika në lidhje me nivelin e zhurmave.




Figura 4: Fotografi gjatë takimeve

4.2. Metodologjia e monitorimit alternativ të zhurmave në zonat bregdetare

Monitorimi alternativ i zhurmës në mjedis ka për qëllim kryesor të vlerësojë situatën e zhurmave në zonat bregdetare, të vlerësojë shkallën e ndikimit të komunitetet lokale dhe të krijojë një bazë të dhënash për të adresuar më mirë problematikat në mënyrë që të ndërtohet një plan masash efikase për të përmirësuar situatën në zonat problematike.

Monitorimi alternativ u përqendrua kryesisht në monitorimin e zhurmës në **zonat bregdetare më problematike** dhe do të konsistojë në monitorimin e zhurmave të vazhdueshme, duke përdorur parametrin *L_{Aeq}*, pasi zhurmat në këto zona janë të tilla. Monitorimi u krye fillimisht nga ekspertët dhe më pas përfaqësues nga komunitetet lokale të cilët u trajnuan mbi realizimin e monitorimit të

zhurmave. Për realizimin e matjeve në Bashkinë Vlorë u angazhuan 2 aktivistë lokalë por dhe vullnetarë.

Monitorimi alternativ i zhurmës u realizua në mënyrë manuale (jo me stacione automatike të monitorimit të zhurmës) nëpërmjet pajisjes zhurmë-matëse **Enno Logic eS528L**.⁶ EnnoLogic eS528L është një matës profesional i nivelit të zhurmave që siguron matje në një interval prej 30 deri në 130 dBA me një saktësi prej $\pm 1,5$ dB. Nëpërmjet këtij matësi mund të regjistrohen vlerat maksimale dhe minimale të nivelit të zhurmave. Ky instrument shëben për të matur dhe regjistruar nivelet e zhurmës në zyra, fabrika, në lagje ose në shtëpi.

Monitorimi i zhurmave u realizua përgjatë muajve të vitit 2023- 2024. Për secilin prej muajve u realizuan matjet e nivelit të zhurmave gjatë ditëve të javës si dhe gjatë fundjavës në orare të paracaktuara me qëllim që të bëhej një krahasim ndërmjet ditëve por edhe orareve të cilat ishin më problematike.

Metodologjia e monitorimit të zhurmave (57 stacione monitorimi në Vlorë) (9 stacione monitorimi në Plazhi I vjeter)	Muaji Gusht 2023	Gjatë ditëve të javës	Paradite (ora 10:00- 12:00) Darkë (ora 20:00-24:00)
		Gjatë fundjavës	
	Muaji Shtator 2023	Gjatë ditëve të javës	Paradite (ora 10:00- 12:00) Darkë (ora 20:00-24:00)
		Gjatë fundjavës	

Tabela 3: Metodologjia e monitorimit të zhurmavë në Bashkinë Vlorë

Të gjitha të dhënat e monitoruara për zhurmën u paraqitën nëpërmjet hartave të realizuara nga aplikacioni GIS. Hartat u gjeneruan për Bashkinë Vlorë dhe evidentojnë zonat me nivelet më të larta dhe më të ulta të ndotjes nga zhurmat.

Skema e përgjithshme e monitorimit manual të zhurmës në mjedis

Proçesi i monitorimit të zhurmave në Bashkinë Vlorë u realizua sipas skemës së mëposhtme:

⁶ Aneks IV. Pajisja e përdorur për monitorimin e zhurmave në bashkinë vlorë




Figura 5: Skema e monitorimit alternativ të zhurmave në zonat bregdetare

5. PERCEPTIMI QYTETAR MBI NIVELIN E ZHURMAVE NE BASHKINË VLORË

5.1 Rezultatet nga pyetësorët e zhvilluar me qytetarët në Bashkinë Vlorë

Bazuar në analizimin e pyetësorëve të realizuar me qytetarët në Bashkinë e Vlorës ka rezultuar se:

- Vërehet një mungesë informacioni e qytetarëve për nivelin e zhurmave në zonat ku ata banojnë, ku 50% e tyre janë shprehur se nuk janë të informuar mbi nivelin e zhurmave.
- Për sa i përket ekspozimit nga zhurmat, rezulton se 62% e të anketuarve janë shprehur se janë të ekspozuar ndaj zhurmave **shpesh**, 26.9 % e tyre janë shprehur se janë të ekspozuar ndaj zhurmave **ndonjëherë**, 9.8 % e të anketuarëve janë shprehur se janë të ekspozuar ndaj zhurmave **rrallë** dhe vetëm 1.3% e tyre nuk e konsiderojnë veten të ekspozuar ndaj zhurmave.
- Intervalet kohore më të zhurmshme kanë rezultuar përgjatë mbrëmjes (18:00 – 00:00), ku rreth 47% e individëve i perceptojnë burimet e zhurmës gjatë këtij intervali, megjithëse vlen të konsiderohet mëngjesi (06:00 – mesditë) ku (41%) e të pyeturve dhe pasdite

(mesditë – 18:00) ku (31.7%) e të pyeturve janë përgjigjur gjithashtu se gjatë këtij harku kohor ka zhurmë. Vetëm 1.3% e të anketuarve shprehen se nuk ka zhurmë gjatë 24 orëve.

- Për sa i përket efekteve të zhurmës te individët, ka rezultuar se 52% e qytetarëve kanë pohuar se ndjenë zemërim në momentin kur janë të ekspozuar ndaj ndotjes akustike, 31% prej tyre ndiheshin shumë të shqetësuar, 22.7% e tyre janë shprehur se ndjehen të frustruar dhe vetëm 7.3% e tyre ndjehen të pa prekur nga efektet e zhurmës. Shumica e të intervistuarve (89.6%) e konsideronin zhurmën jo vetëm si një problem që shkakton bezdisje por dhe besonin se ekspozimi ndaj saj mund të shkaktojë ose përkeqësojë gjendjen shëndetësore.
- Për sa i përket shpeshtësisë së ekspozimit ndaj zhurmave, 40.6% të tyre pohuan se shpeshtësia e zhurmës nuk ka pësuar ndryshim, ndërsa për 16.4% të tyre ajo është ulur. Ndërsa 43% e të anketuarve tani dëgjojnë më shpesh zhurmë.
- Në lidhje me shqetësimin e perceptuar për shkak të burimeve të zhurmës së lëvizshme 98.7% e të intervistuarve deklaruan se janë të shqetësuar nga të paktën një lloj burimi. Vihet re se ndotësi më i madh për sa i përket zhurmave është transporti rrugor me 59.9% dhe si pasojë boritë e automjeteve me 45.2%. Gjithashtu ndërtimet zënë një vlerë prej 47.5%, ndërsa bizneset (bare/klube, restorante, dyqane) që luajnë muzikë me zë të lartë zënë vetëm 44.5%.
- Referuar vendimeve dhe rregulloreve të hartuara dhe të miratuara nga Bashkia Vlorë, 27% e të anketuarve janë në djeni se ka një rregullore nga Bashkia Vlorë mbi ndotjen akustike dhe 73% e tyre nuk e njohin këtë fakt.
- Sipas perceptimit të qytetarëve, roli i medias në raportimin e gjendjes së ndotjes nga zhurmat ishte i ulët.
- Për sa i përket rolit të institucioneve në zgjidhjen e problematikave mbi nivelin e zhurmave, rezultoi se (46%) janë ankuar pranë Policisë së Shtetit dhe (23%) pranë Bashkisë Vlorë. Më pak janë ankuar pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe Mediave.
- Përgjatë sezonit të verës, sipas qytetarëve, zona më e ndotur ka qenë bregu i detit (79%), Skelë (7%), Qendër dhe bulevardi nga (5%) dhe më pak zona e Muradies dhe Sheshi i flamurit (3%). Duke qenë se njerëz të ndryshëm përgjigjen ndryshe ndaj stimulit të zhurmës 1% e qytetarëve nuk ndiejnë shqetësim.
- Përgjatë pjesës tjetër të vitit, jashtë sezonit të verës 67% e qytetarëve shprehen se Qendra (sheshi i Flamurit, Kapelja dhe pranë Bashkisë) gjeneron ndotje dhe 21% mendojnë se bulevardi “Ismail Qemali” gjeneron ndotje akustike. Për zonën e Skelës mendojnë vetëm 10% e tyre dhe më pak se (2%) kanë shpërndarje në lagje të ndryshme të qytetit.

5.2 Rezultatet nga workshopet e zhvilluara me grupet e interesit

Zonat e evidentuara si problematike për sa i përket nivelit të zhurmave në Bashkinë Vlorë janë si më poshtë vijon:

- **Rruga “Transballkanike”**
- **Në zonën e Plazhi i vjeter**
- **Aksi rrugor “Vlorë- Skelë” (zona e Skelës)**

- **Zona e Lungomares**
- **Lagja “Çentrale”**
- **Lagja “Partizani”**
- **Sheshi i Flamurit dhe Xhamia Muradie**



Figura 6: Harta e Bashkisë Vlorë


6. VLERËSIMI I NIVELIT TË ZHURMAVE DHE HARTËZIMI I TYRE NË BASHKINË Vlorë

6.1. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Gusht 2023 (Zona bregdetare Vlorë)

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave për 57 stacionet e monitorimit në zonën bregdetare Vlorë, **gjatë ditëve të javës për muajin Gusht 2023⁷** rezultoi se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **72.65 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **48.55 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **65.78 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standartin prej **55 dB** gjatë ditës.
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **74.75 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **48.7 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **65.81 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë vlerën standarde prej 45 dB gjatë darkës.

Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës (Gusht 2023)



⁷ Aneks I. Hartat e ndotjes akustike gjatë ditëve të javës për muajin Gusht 2023, Zona bregdetare Vlorë

Figura 7: Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Gusht 2023), Vlorë

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara gjatë monitorimit të zhurmave për 57 stacionet e monitorimit në zonën bregdetare Vlorë, **gjatë fundjavës**⁸ për muajin **Gusht 2023** rezulton se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **73 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **52.05 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **65.38 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standartin prej **55 dB** gjatë ditës
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **78 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **47.7 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **66 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë standartet prej **45 dB** gjatë darkës.




Figura 8: Niveli i zhurmave gjatë fundjavës paradite dhe darkë (Gusht 2023) Vlorë

⁸ Aneks I. Hartat e ndotjes akustike gjatë fundjavës për muajin Gusht 2023, Zona bregdetare Vlorë

6.2. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Shtator 2023 (Zona bregdetare Vlorë)

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave për 57 stacionet e monitorimit në zonën bregdetare Vlorë, **gjatë ditëve të javës për muajin Shtator 2023**⁹ rezultojnë se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **73 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **46.7 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **64.6 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standartin prej **55 dB** gjatë ditës
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **74 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **47.73 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **64.5 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë standartet prej **45 dB** gjatë darkës.




Figura 9: Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Shtator 2023), Vlorë

⁹ Aneks I. Hartat e ndotjes akustike gjatë ditëve të javës për muajin Shtator 2023, Zona bregdetare Vlorë

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave për 57 stacionet e monitorimit në zonën bregdetare Vlorë, **gjatë fundjavës** për muajin **Shtator 2023**¹⁰ rezultoi se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **69.7 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **49.7 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **62.4 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standardin prej **55 dB** gjatë ditës
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **76.29 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **46.64 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **64.6 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë standartet prej **45 dB** gjatë darkës.




Figura 10: Niveli i zhurmave gjatë fundjavës paradite dhe darkë (Shtator 2023), Vlorë

¹⁰ Aneks I. Hartat e ndodhjes akustike gjatë fundjavës për muajin Shtator2023, Zona bregdetare Vlorë

6.3. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Gusht 2023 (Zona Plazhi i vjeter)

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave për 9 stacionet e monitorimit në zonën e Plazhi i vjeter, **gjatë ditëve të javës për muajin Gusht 2023**¹¹ rezultoi se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **63.04 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **59.08 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **61 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës këto vlera tejkalojnë standartin prej **55 dB** gjatë ditës.
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **67.16 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **51.3 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **59.4 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë standartet prej **45 dB** gjatë darkës.




Figura 11: Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Gusht 2023), Plazhi i vjeter

¹¹ Aneks II. Hartat e ndotjes akustike gjatë ditëve të javës për muajin Gusht 2023, Zona Plazhi i Vjeter

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara gjatë monitorimit të zhurmave për 9 stacionet e monitorimit në zonën e Plazhi i vjeter, **gjatë fundjavës për muajin Gusht 2023**¹² rezultoi se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **66.12 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **52.22 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **60.58 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standardin prej **55 dB** gjatë ditës.
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **64.48 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **48.98 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **59.05 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës vlera tejkalonë standartet prej **45 dB** gjatë darkës.




Figura 12: Niveli i zhurmave gjatë fundjavës paradite dhe darkë (Gusht 2023), Plazhi i vjeter

¹² Aneks II. Hartat e ndotjes akustike gjatë fundjavës për muajin Gusht 2023, Zona Plazhi i vjeter

6.4. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Shtator 2023 (Zona Plazhi i vjeter)

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave për 9 stacionet e monitorimit në zonën e Plazhi i vjeter, **gjatë ditëve të javës për muajin Shtator 2023**¹³ rezultojnë se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **61.2 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **50.55 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **59.3 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlerat tejkalojnë vlerën standarde prej 55 dB gjatë ditës dhe vetëm në stacionet e monitorimit 60 (51.1 dB) dhe 61 (50.55 dB) vlerat nuk tejkalojnë vlerën standarde gjatë ditës.
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **65.2 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **49.8 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **57.62 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës vlera tejkalonë standartet prej **45 dB** gjatë darkës.




Figura 13: Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Shtator 2023), Plazhi i vjeter

¹³ Aneks II. Hartat e ndotjes akustike gjatë ditëve të javës për muajin Shtator 2023, Zona Plazhi i vjeter

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave 9 stacionet e monitorimit në zonën e Plazhi i vjeter, **gjatë fundjavës** për muajin **Shtator 2023**¹⁴ rezultojn se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **64.2 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **50.7 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **58.81 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlerat tejkalojnë vlerën standarte prej 55 dB gjatë ditës dhe vetëm në stacionet e monitorimit 60 (52.2 dB) dhe 61 (50.7 dB) vlerat nuk tejkalojnë vlerën standarte gjatë ditës.
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **62.6 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **47.55 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **57.33 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës vlera tejkalonë standartet prej **45 dB** gjatë darkës.




Figura 14: Niveli i zhurmave gjatë fundjavës paradite dhe darkë (Shtator 2023)

¹⁴ Aneks II. Hartat e ndojës akustike gjatë fundjavës për muajin Shtator 2023, Zona Plazhi i vjeter

7. KONKLUZIONE

- Rreth 98.7% e të intervistuarëve janë shprehur së janë të ekspozuar ndaj nivelit të zhurmave.
- Intervalet kohore më të zhurmshme kanë rezultuar përgjatë mbrëmjes (18:00 – 00:00), ku rreth 47% e individëve i perceptojnë burimet e zhurmës gjatë këtij intervali, megjithëse vlen të konsiderohet mëngjesi (06:00–mesditë) ku (41%) e të pyeturve dhe pasdite (mesditë –18:00) ku (31.7%) e të pyeturve janë përgjigjur gjithashtu se gjatë këtij harku kohor ka zhurmë. Vetëm 1.3% e të anketuarve shprehen se nuk ka zhurmë gjatë 24 orëve.
- Për sa i përket efekteve të zhurmës te individët, ka rezultuar se 52% e qytetarëve kanë pohuar se ndjenë zemërim në momentin kur janë të ekspozuar ndaj ndotjes akustike, 31% prej tyre ndiheshin shumë të shqetësuar, 22.7% e tyre janë shprehur se ndjehen të frustruar dhe vetëm 7.3% e tyre ndjehen të pa prekur nga efektet e zhurmës. Shumica e të intervistuarve (89.6%) e konsideronin zhurmën jo vetëm si një problem që shkakton bezdisje por dhe besonin se ekspozimi ndaj saj mund të shkaktojë ose përkeqësojë gjendjen shëndetësore.
- Për sa i përket shpeshtësisë së ekspozimit ndaj zhurmave, 40.6% të tyre pohuan se shpeshtësia e zhurmës nuk ka pësuar ndryshim, ndërsa për 16.4% të tyre ajo është ulur. Ndërsa 43% e të anketuarve tani dëgjojnë më shpesh zhurmë.
- Në lidhje me shqetësimin e perceptuar për shkak të burimeve të zhurmës së lëvizshme 98.7% e të intervistuarve deklaruan se janë të shqetësuar nga të paktën një lloj burimi. Vihet re se ndotësi më i madh për sa i përket zhurmave është transporti rrugor me 59.9% dhe si pasojë boritë e automjeteve me 45.2%. Gjithashtu ndërtimet zënë një vlerë prej 47.5%, ndërsa bizneset (bare/klube, restorante, dyqane) që luajnë muzikë me zë të lartë zënë vetëm 44.5%.
- Sipas perceptimit të qytetarëve, roli i mendia në raportimin e gjendjes së ndotjes nga zhurmat ishte i ulët.
- Për sa i përket rolit të institucioneve në zgjidhjen e problematikave mbi nivelin e zhurmave, rezulton se (46%) janë ankuar pranë Policisë së Shtetit dhe (23%) pranë Bashkisë Vlorë. Më pak janë ankuar pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe Mediave vizive dhe atyre të shkruara.
- Përgjatë sezonit të verës, sipas qytetarëve, zona më e ndotur ka qenë bregu i detit (79%), Skelë (7%), Qendër dhe bulevardi nga (5%) dhe më pak zona e Muradies dhe Sheshi i flamurit (3%). Duke qenë se njerëz të ndryshëm përgjigjen ndryshe ndaj stimulit të zhurmës 1% e qytetarëve nuk ndiejnë shqetësim.
- Përgjatë orareve të paraditës (muaji Gusht), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 72.65 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 48.55 dB. (norma e lejuar është 55 db)
- Përgjatë orareve të darkës (muaji Gusht), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 74.75 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 48.7 dB. (norma e lejuar është 45 db)

- Përgjatë orareve të paraditës ne fundjave (muaji Gusht), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 73 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 52.05 dB. (norma e lejuar është 55 db)
- Përgjatë orareve të darkës (muaji Gusht), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 78dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 47.7 dB. (norma e lejuar është 45 db)
- Përgjatë orareve të paraditës (muaji Shtator), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 73 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 46.7 dB. (norma e lejuar është 55 db)
- Përgjatë orareve të darkës (muaji Shtator), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 74 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 47.73 dB. (norma e lejuar është 45 db)
- Përgjatë orareve të paraditës ne fundjave (muaji Shtator), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 69.7 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 49.7 dB. (norma e lejuar është 55 db)
- Përgjatë orareve të darkës (muaji Shtator), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 76.29 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 46.64 dB. (norma e lejuar është 45 db)
- Në bashkinë Vlore zonat me nivelin më të lartë te zhurmave ka rezultuar të jenë përgjatë lungomares, nga bulevardi deri në skelë dhe rruga transballkanike.
- Përgjatë orareve të paraditës (gjate diteve te javes/zona e Plazhi i vjeter/muaji Gusht), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 63.04 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 59.08 dB. (norma e lejuar është 55 db)
- Përgjatë orareve të darkës (muaji Gusht), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 67.16 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 51.3 dB dB. (norma e lejuar është 45 db)
- Përgjatë orareve të paraditës ne fundjave (muaji Gusht), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 66.12 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 52.22 dB. (norma e lejuar është 55 db)
- Përgjatë orareve të darkës (muaji Gusht), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 64.48 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 48.98 dB. (norma e lejuar është 45 db)
- Përgjatë orareve të paraditës (muaji Shtator/zona e Plazhi i vjeter), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 61.2 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 50.55 dB. (norma e lejuar është 55 db)
- Përgjatë orareve të darkës (muaji Shtator/zona e Plazhi i vjeter), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 65.2 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 49.8 dB. (norma e lejuar është 45 db)
- Përgjatë orareve të paraditës ne fundjave (muaji Shtator/zona e Plazhi i vjeter), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 64.2 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 50.7 dB. (norma e lejuar është 55 db)
- Përgjatë orareve të darkës (muaji Shtator/zona e Plazhi i vjeter), nga monitorimet ka rezultuar që niveli maksimal i zhurmave është 62.6 dB ndërsa vlera minimale e zhurmavë është 47.55 dB. (norma e lejuar është 45 db)

8. MASAT E PROPOZUARA PËR REDUKTIMIN E ZHURMAVE NË MJEDIS


Me qëllim menaxhimin e zhurmave janë propozuar një seri masash dhe aktorët përgjegjës për menaxhimin e tyre. Masat e propozuara adresojnë fuqizimin institucional të bashkisë dhe forcimit të ligjit që i detyron autoritetet lokale në një monitorim më të vazhdueshëm të nivelit të zhurmave. Përmisimi i infrastrukturës nëpërmjet vendosjes së sinjalistikës në vende të caktuara ku niveli i zhurmave është më i lartë dhe ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i komuniteteve për reduktimin e zhurmave.

Nr	Objektivi prioritar	Masat prioritare	Roli/përgjegjësia
1	Fuqizimi institucional i Bashkisë Vlorë për menaxhimin e zhurmave	Zbatimi i legjislacionit për zhurmat	Drejtoria Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota
		Trajnime të stafit të Bashkisë të cilët janë përgjegjës në kontrollin e zhurmës	Drejtoria Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota
		Hartimi dhe funksionimi i mekanizmit të trajtimit të ankesave për zhurmat. Vendosja e një numri telefonik për të mbledhur ankesat dhe kontaktin përkatës.	Drejtoria Juridike, Policia Bashkiake, Drejtoria Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota
2	Zbatimi i ligjit dhe masave për kontrollin e zhurmës	Kontrolle të herë pas herëshme në mjedise të brendshme për nivelin e zhurmës (vecanërisht baret që përdorin muzikë në nivele mbi normat e lejuara për zhurmat në mjedise të mbyllura)	Policia Bashkiake/Drejtoria Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota
		Këshillimi dhe penalizimi nga Policia Bashkiake në rast të reniës së borisë (pa shkak, në trafik) në zonat bregdetare dhe urbane.	Policia Bashkiake
3	Përmirësimi i infrastrukturës për reduktimin e zhurmave	Vendosja e sinjalistikës së nevojshme për kufizimin e shpejtësisë në rrugët dhe zonat më problematike.	Policia Bashkiake
4		Promovimi i masave për kontrollin e zhurmave në faqen elektronike të Bashkisë dhe në rrjetet sociale të Bashkisë	Drejtoria e Burimeve Njerëzore/ Drejtoria Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota

9. ANEKS I. HARTAT E ZHURMAVE PËR BASHKINË VLORË (ZONA BREGDETARE)

HARTA E NDOTJES AKUSTIKE GJATË DITËVE TË JAVËS

ZONA BREGDETARE (BASHKIA VLORË)




MUAJI GUSHT 2023


HARTA E NDOTJES ANUJTIKE GIATË FUNDIAVËS

ICOMA BRESQETARE (BASHKIDA VLORE)

PARAMETRE




ESKIZH



MUAJI GUSHT 2023

HARTA E NDOTJES AKUSTIKE GIATË DITËVE TË JAVËS

ZONA BREGDETARE (BASHKIA VLORE)
 MUAJI SHTATOR





MUAJI SHTATOR 2023


HARTA E NDOTJES AKUSTIKE GJATË FUNDJAVËS

ZONA BREGDETARE (BASHKIA VLORE)
MUAJI SHTATOR



PARADITE



Legjenda
Simboli - shprehës i ndotjes



DARËNË



Legjenda
Simboli - shprehës i ndotjes



11. ANEKS III. PAJISJA E PËRDORUR PËR MONITORIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË VLORË



Punoi:

Drejtoria e Bujqësisë, Mbrojtjes së
Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota

Znj. Aulona Veizi

Drejtoria Juridike

Z. Dorian Demiri